

THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË TRAJNIM MBI PËRGATITJEN E PROJEKTEVE PËR SHKOLLAT E MESME DHE ORGANIZATAT QYTETARE NGA MAQEDONIA E VERIUT

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, shpall thirrje për pjesëmarrje në trajnim mbi ngritjen e kapaciteteve në përgatitjen e projekteve për mobilitetin, bashkëpunim dhe aktivizim rinor në Ballkanin Perëndimor. Në këtë thirrje mund të paraqiten përfaqësuesë të shkollave të mesme dhe organizatave qytetare nga Maqedonia e Veriut. Trajnimi do të zhvillohet nga data **21 deri më 23 qershor 2023, në Hotel Scardus, Kodra e Diellit.**

QËLLIMI I TRAJNIMIT:

Trajnimi ka për qëllim të rrit nivelin e njohurive dhe kapacitetin e organizatave qytetare dhe shkollave të mesme, që të njëjtat në mënyrë të pavarur dhe me sukses të përgatisin propozim projekte, duke respektuar parimin e pjesëmarrjes inkluzive të të rinjve.

Në kuadër të trajnimit, pjesëmarrësit do të njihen me konceptet e arsimit ndërkulturor, pajtimin, pjesëmarrjen e të rinjve dhe përfshirjen sociale, si dhe mundësitë për partneritete në rajon. Pjesëmarrësit në trajnim do të fitojnë njohuri teorike dhe praktike për zhvillimin e elementeve kryesore në aplikimin e projekteve - fillimisht nga arsytimi i idesë, duke vazhduar me vendosjen e qëllimeve dhe aktiviteteve, deri tek formimi i një buxheti real dhe aktiviteteve promovuese të përpiluara mirë.

KUJT I DEDIKOHET TRAJNIMI:

Ky trajnim është i dizajnuar për përfaqësuesit e shkollave të mesme dhe organizatave qytetare në vend, të cilat nuk kanë aspak ose kanë përvojë shumë të kufizuar në përgatitjen dhe realizimin e projekteve. Më konkretisht, parametrat e mëposhtëm do të merren parasysh gjatë përzgjedhjes së kandidatëve:

PËRFAQËSUESIT E SHKOLLAVE TË MESME	PËRFAQËSUESIT E ORGANIZATAVE QYTETARE
→ Të cilët planifikojnë të udhëheqin procesin dhe të hartojnë propozim projekt para institucionit të tyre	→ Të cilët planifikojnë të udhëheqin procesin dhe të hartojnë propozim projekt para organizatave të tyre
→ Të cilët mund tërësisht t'i përkushtohen trajnimit	
→ Ata që kurrë nuk kanë qenë bartës të ndonjë projekti rajonal më parë	
→ Ata që nuk kanë qenë kurrë më parë bartës apo partner të projekteve të financuara nga Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor	
→	→ Të cilët nuk kanë realizuar projekte me vlerë më të lartë se 10,000 euro

→	→ Të cilët janë të regjistruara më pak se 3 vjet
! RYCO inkurajon pjesëmarrjen e shkollave dhe organizatave nga komunitetet më të vogla dhe/ose multietnike	

SI TË APLIKONI PËR Pjesëmarrje:

Regjistrimi për këtë trajnim zgjat deri më 15 qershor 2023. Në emër të një shkolle/organizate kanë mundësi të aplikojnë si përfaqësues dy persona. Aplikacionet bëhen duke plotësuar formularin në: <https://forms.gle/nxyH4GcVhhBPE6Hp8>

Përzgjedhja e pjesëmarrësve do të bëhet në bazë të kriterëve të lartpërmendura, duke respektuar barazinë gjinore dhe gjeografike. Rezultatet e përzgjedhjes do të publikohen më 16 qershor 2023 dhe kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen përmes telefonit ose postës elektronike.

INFORMATA SHITESË:

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) është një mekanizëm i pavarur institucional i Ballkanit Perëndimor, i themeluar në mënyrë që të promovojë frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit ndërmjet të rinjve në rajon. Në kuadër të punës së vet, RYCO mbështet projekte që kontribuojnë për pajtimin në rajon përmes rritjes së mobilitetit të rinisë, bashkëpunimit dhe aktivizmit. Me qëllim që shumica e të interesuarve të kenë mundësinë për t'iu përgjigjur RYCO dhe thirrjeve të ngjashme për përgatitjen e projekteve, RYCO organizon trajnim mbi ngritjen e aftësive në këtë sferë.

Trajnimi do të zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe do të ketë përkthim në gjuhën shqipe.

Të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes (udhëtimi, vendosja, ushqimi) do të mbulohen nga ana e Misionit të OSBE-së në Shkup.

KONTAKT:

Për pyetje dhe sqarime shtesë, mund të kontaktoni Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) në Shkup në north.macedonia@rycowb.org

Shënim: Pjesëmarrja në trajnim nuk është garanci për ndarjen e fondeve për zbatimin e projekt propozimeve nga RYCO.